



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSE", VLORE

VENDIM

Nr. 4, Dt. 27.03.2008

Per miratim leje, per shfrytezim inertesh ne shtratin e lumit Vjose, ne nje mjedis teresisht lumor, ne afersi te fshatit Qesarat (ne jug -perendim te tij) komuna Qesarat, Qarku Gjirokaster, subjektit "Boka - Axxh" sh.p.k, Tirane.

Ne zbatim te kerkesave qe percakton Ligji Nr.8093 Dt. 21/03/1996 "Per Rezervat Ujore", konkretisht, neni 8 dhe 20, vendimit nr. 1 dhe nr. 3, dt.21.06.2006, te K.K.U-se, si dhe vendimit nr.2 dt. 07.06.2007 te K.K.U-se, duke gjykuar mbi kerkesen dhe studimin e paraqitur nga subjekti "Boka - Axxh" sh.p.k, Tirane, konform formularit "E", pasqyruar dhe ne relacionin shoqerues, paraqitur nga A.U.B "Vjose". Keshilli i Basenit Ujembledhes "Vjose",

VENDOSI:

- 1- Te miratoj lejen, per shfrytezim inertesh ne shtratin e lumit Vjose, ne afersi te fshatit Qesarat (ne jug - perendim te tij), Komuna Qesarat, Qarku Gjirokaster, subjektit "Boka - Axxh" sh.p.k. Tirane.
- 2- Siperfaqja e dhene ne shfrytezim (per 5 vjet) do te jete 0.3 km².
E kufizuar nga piketat, me koordinata si me poshte.

X 1 = 44 73 100	Y 1 = 44 04 550
X 2 = 44 72 200	Y 2 = 44 04 550
X 3 = 44 73 675	Y 3 = 44 02 390
X 4 = 44 72 910	Y 4 = 44 02 070
- 3- Leja e shfrytezimit jepet per 5 vjet, me te drejte rinovimi cdo 3 vjet.
- 4- Koha e shfrytezimit te zones do te jete ajo e percaktuar ne vendimin nr.1, dt. 21.06.2006 te K.K.U-se, nga dt.01.06 deri me 31.10, te cdo viti.
- 5- Volumi i materialit qe do te merren per 3 vjet do te jete 36 000 m³, me nje mesatare vjetore 12 000 m³/vit, brenda zones qe jepet ne shfrytezim, thellesia e shfrytezimit deri ne 1.5 m, por jo me shume se 0.5 m mbi pasqyren e ujrave fratike.
- 6- Ngarkohet A.U.B "Vjose" per zbatimin e ketij vendimi.
- 7- Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

KRYETARI K.B.U "VJOSE"
Ahevan REXHEPI

PERGJEGJESI A.U.B-se "VJOSE"
Vezir METAJ

